

SHOQËRIA "ABISSNET"SHA
NIPT: K01417001C
ADRESA E SELISË: "ISMAIL QEMALI",
PLL.18, K.2, TIRANË

VENDIM NR. 14
DATË 28.12.2021
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "ABISSNET" SHA

Sot, më datë 28.12.2021, ora 10:00, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18, Tiranë, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Abissnet" sha. Në këtë mbledhje është i pranishëm aksionari i vetëm i shoqërisë "Abissnet" sha, shoqëria "2K Group" shpk, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "Abissnet"sha, përfaqësuar personalisht nga ortakët e saj si më poshtë:

- Z. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Znj. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35% të kapitalit të shoqërisë;

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve u thirr për të diskutuar çështjet e përfshira në rendin e ditës, të njoftuar paraprakisht aksionarëve, si më poshtë:

1. Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë "Abissnet"sha, për vitin 2020, të përgatitur nga audituesi ligjor, Bujar Rami, me Licencë nr. 90, datë 07.12.2000, NUIS L21501047E.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, pasi shqyrtoi çështjet e përfshira në rendin e ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Zmadhimit të Kapitalit, përgatitur nga audituesi ligjor Bujar Rami, me Licencë nr. 90, datë 07.12.2000, NUIS L21501047E.
2. Sipas bilancit vjetor të shoqërisë "Abissnet"sha, për vitin 2020, shoqëria rezulton me fitim në shumën 52,915,457 (pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë. Ky fitim është destinuar në këtë mënyrë:
 - Shuma prej 2,915,457 (dy milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) Lekë të destinohet për fondin e rezervës ligjore.
 - Shuma prej 50,000,000 (pesëdhjetë milion) Lekë të destinohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë përmes emetimit të 50,000 (pesëdhjetë mijë) aksioneve të reja me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë për aksion.



Pas këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë “Abissnet” sha bëhet 607,400,000 (gjashtëqind e shtatë milion e katërqind mijë) aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë secili, të zotëruar nga aksionarët sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Aksionerët | ISHTE | | | BËHET | | |
|----|---------------|-------------------|----------------|--------------------|-------------------|----------------|--------------------|
| | | Numri i aksioneve | % pjesëmarrjes | Kontributi në Lekë | Numri i aksioneve | % pjesëmarrjes | Kontributi në Lekë |
| 1 | 2K Group shpk | 557,400 | 100 | 557,400,000 | 607,400 | 100 | 607,400,000 |
| | Shuma | 557,400 | 100 | 557,400,000 | 607,400 | 100 | 607,400,000 |

**SHOQËRIA “ABISSNET”SHA
AKSIONARI I VETËM
“2K GROUP” SHPK
Përfaqësuar nga ortakët**

Koço KOKËDHIMA

Brixhilda KOKËDHIMA



